# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5798
E martë, 11 qershor 2019
çmimi 0.40 €


## Çitaku kërkon përfundimin e mandatit të UNMIK-ut në Kosovë

FAQE 2





Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", DHURATA HOXHA

# Kërkojmë liberalizim sa më të shpejtë të vizave për Kosovën

FAQE 4-5



Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka bërë me dije se Qeveria e Kosovës është duke punuar maksimalisht që sa më shpejt çështja e liberalizmit të vizave të hyjë në agjendë të Këshillit të Bashkimit Evropian (BE). Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se derisa të sigurohet shumica e votave në Këshill të BE-së nuk do të hyjë kjo çështje në rend të ditës. Ministrja Hoxha ka thënë se nuk ka dilema rreth përkrahjes së Gjermanisë për liberalizimin e vizave për Kosovën por, sipas saj, konstituimi dhe lëvizjet pas zgjedhjeve dhe përbërjes së re të Parlamentit Evropian, kërkojnë përmbushje të procedurave që kërkojnë kohë me ndikim në proces. Megjithatë, Hoxha ka thënë se Kosova kërkon liberalizim sa më të shpejtë të vizave për qytetarët e saj

## OPINION

### GJENOCIDI, TERMI 'ASGJËSIM' DHE KODI PENAL I KOSOVËS

F. 11



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

### BASHKIMIN ME SHQIPËRINË E PAMUNDËSON KUSHTETUTA E KOSOVËS DHE JO BE-ja

F. 11



Ismet HAJRULLAHU

### ME DY SHQIPTARË TË MËDHENJ

F. 13



Ismet SYLEJMANI

## AKTUALE

### UP-JA SHËNON 20-VJETORIN E ÇLIRIMIT TË KOSOVËS ME KONFERENCË SHKENCORE

F. 2

## EKONOMI

### SHYQYRI HAXHA: KONTRATA ME 'Z-MOBILE' ISHTE KRYER PARA SE UNË TË BËHESHA KRYESHEF I PTK-së

F. 9

## KULTURË

### 'BLEIBENDE SPUREN' PËRFAQËSON FATIN E MIJËRA SHQIPTARËVE

F. 12-13





## Clintoni dhe Albrighti vijnë për ta festuar 20-vjetorin e çlirimit të Kosovës

## Hoxhaj: Pika kufitare me Maqedoninë e Veriut lëshohet për qarkullim në fund të gushtit




RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Palmer: ShBA-ja e mbështet dialogun, taksa të hiqet

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Shtetet e Bashkuara e mbështesin dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian midis Kosovës dhe Serbisë, tha zëvendësndihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit, Matheë Palmer, pas një takimi me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në Beograd. "Shohim se taksa është pengesë e tij. Duam që ajo të hiqet dhe në këtë mënyrë të dyja palët t'i kthehen tryezës së bisedimeve", tha Palmeri, duke folur për tarifën 100 % që Kosova u ka vënë prodhimeve të importuara nga Serbia, në nëntor të vitit të kaluar. Që nga ky vendim, Serbia është tërhequr nga dialogu për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën, duke thënë se negociatat nuk do të vazhdojnë pa heqjen e taksës. Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga kryeministri Haradinaj, ka thënë se taksa nuk do të hiqet derisa Serbia nuk e njeh Kosovën. I pyetur se çfarë pret nga takimi i përfaqësuesve të Kosovës dhe Serbisë, i cili pritet të mbahet më 1 korrik në Paris, nën organizimin e Gjermanisë dhe Francës, Palmer tha se Uashingtoni e mbështet plotësisht atë që bëjnë partnerët evropianë për zgjidhjen e problemit.



# Çitaku kërkon përfundimin e mandatit të UNMIK-ut

Në seancën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ambasadorja e Kosovë në ShBA, Vlora Çitaku, ka kërkuar edhe një herë përfundimin e mandatit të UNMIK-ut, duke thënë se nuk ka asnjë arsye për vazhdimin e punës së misionit të OKB-së pasi Kosova tashmë është shtet i pavarur dhe i kryen të gjitha detyrat e veta




PRISHTINË, 10 QERSHOR - Ambasadorja e Kosovës në Uashington, Vlora Çitaku, ka kërkuar edhe një herë përfundimin e mandatit të UNMIK-ut, duke thënë se nuk ka asnjë arsye për vazhdimin e punës së misionit të OKB-së pasi Kosova tashmë është shtet i pavarur dhe i kryen të gjitha detyrat e veta.

Gjatë fjalimit në seancën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për punën e rregullt të UNMIK-ut në Kosovë, Çitaku ka theksuar se më mirë do të ishte që resurset që ndahen për UNMIK-un të përdoren diku tjetër. "Kosova ka pasur të drejtë me rastin e shpalljes së pavarësisë dhe nuk ka pasur asnjë shkelje. Situata në Kosovë më 2019 është shumë më ndryshe në krahasim me atë kur erdhi UNMIK-u. Vendi ynë po bëhet më i integruar në bashkësinë ndërkombëtare. Ne nuk shohim arsye për vazhdimin e mandatit të UNMIK-ut, pasi Kosova e qeveris vetveten. A mundet dikush në këtë sallë të më tregojë se cila është puna e UNMIK-ut aktualisht në Kosovë. Resurset e ndara për këtë mision do të ishte më e mirë të shfrytëzohen për diku tjetër. Policia e Kosovës vepron me standardet më të larta të profesionalizmit dhe integritetit, dhe është partner kredibil në luftimin e krimit të organizuar dhe terrorizmit, për të parandaluar komplotet e rrezikshme", është shprehur Çitaku.

Ajo ka folur edhe rreth aksionit të Policisë së Kosovës më 28 maj në veri, me qëllim të luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit. "Në përputhje me kërkesën e gjykatës dhe me udhëzimet e zyrës së prokurorit special, Policia e Kosovës ka kryer 19 arrestime, prej tyre 11 serbë, katër shqiptarë dhe katër boshnjakë. Policët janë suspenduar nga puna dhe Policia e Kosovës nuk është ballafaquar me rezistencë me përjashtim në Zubin Potok, ku u ballafaqua me të shtëna nga armët dhe postblloqe të vendosura nga serbët. Me këtë rast, policia ka arrestuar shtatë civilë, në mesin e tyre edhe një diplomat i Kombeve të Bashkuara, i nacionalitetit rus. Ky i fundit ka përdorur automjetin zyrtar të OKB-së për të vendosur barrikadën për të parandaluar Policinë e Kosovës të kryejë detyrën e vet. Ai ka përdorur automjetin për të transportuar një motor-sharrë, e cila është përdorur për të prerë drurët që janë hedhur në rrugë për të parandaluar kalimin e Policisë së Kosovës në Zubin Potok. Ai qëllimisht ka vendosur automjetin e tij para këtyre drunjve për t'i përforcuar barrikadat. Ai ka refuzuar të bashkëpunojë dhe ka mohuar të ofrojë dokumentet identifikuese. Në ditët në vijim atij i është refuzuar qëndrimi në Kosovë dhe ai është transportuar për në Beograd", ka deklaruar Çitaku.

Për më tepër, ajo ka bërë me dije se të gjitha autoritetet relevante kanë qenë të njoftuara për operacionin në veri, ndërsa ka kërkuar hetime për veprimin e pjesëtarit rus të UNMIK-ut, i cili sipas saj ka penguar Policinë e Kosovës të kryerje punën e saj.

Ambasadorja Çitaku ka akuzuar Beogradin zyrtar për retorikën e luftënxitjes dhe frikësimin e popullatës, ndërsa ka shprehur gatishmërinë e Kosovës për vazhdimin e dialogut, duke thënë se është Serbia ajo e cila nuk dëshiron vazhdimin e këtij procesi.

Ndërsa, sa i përket zbatimit të marrëveshjeve të arritura në Bruksel, Çitaku ka thënë se është Beogradi zyrtar që po frikëson serbët lokalë të Kosovës, përmes arrestimit të tyre. Ajo ka përmendur se kryeministri serb Vladan Gjorgjeviq, në vitin 1913 kishte ofenduar shqiptarët duke i quajtur si "njerëz me bisht" dhe se këtë retorikë e ka vazhduar edhe në shekullin 21 kryeministrja Ana Brnabiq, e cila ka thënë se "shqiptarët janë njerëz që kanë dalë nga mali".

## PS-ja nis procedurat për shkarkimin e presidentit Meta

TIRANË, 10 QERSHOR - Partia Socialiste njoftoi të hënën se ka vendosur të nisë procedurat për shkarkimin e presidentit Ilir Meta. Është hera e parë që në Shqipëri, parlamenti do të ndërmarrë një hap të tillë ekstrem, i cili pason vendimin e kreut të Shtetit për të anuluar datën e zgjedhjeve vendore të parashikuara për më 30 qershor.

Në përfundim të mbledhjes së Kryesisë së Partisë, ministrja për Marrëdhëniet me parlamentin Elisa Spiropali deklaroi se me vendimin e tij presidenti ka kryer "një akt brutal ndaj Republikës". Sipas Spiropalit "ne si kryesi mendojmë se Meta ka humbur të drejtën për të qëndruar në atë pozicion". Një qëndrim i paralajmëruar një ditë më parë dhe nga vetë kryeministri Edi Rama, sipas të cilit vendimi i kreut të Shtetit është "një akt që politikisht është vetëvrasje, ligjërisht është nul, nuk ekziston dhe moralisht është turp që s'ka më turp", ndërsa shtoi se "Ilir Meta e ka shkruar fatin e tij si një president që e ka humbur të drejtën të qëndrojë në këtë zyrë".

Spiropali shpjegoi se procedurat për shkarkimin e presidentit të Republikës "do nisin menjëherë në seancën parlamentare të së enjtes. Është detyra jonë politike për të mbrojtur Kushtetutën, rendin kushtetues dhe Republikën".

Procedurat për shkarkimin e presidentit nisin me kërkesën e një të katërtës së deputetëve, ose 36 prej tyre, ndërsa vendimi duhet të merret me të paktën dy të tretat ose 93 vota, të cilat shumica e vetme nuk i ka.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Republika e Kosovës nesër (e mërkurë) shënon 20-vjetorin e hyrjes së trupave të NATO-s

# Clintoni dhe Albrighti vijnë për ta festuar 20-vjetorin e çlirimit të Kosovës

Me aktivitete të ndryshme shteti i Kosovës nesër (e mërkurë) shënon 20-vjetorin e hyrjes së trupave të NATO-s. Shënimi i këtij përvjetori historik do të festohet bashkë me miqtë dhe aleatët tanë. Ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Bill Clinton dhe ish-sekretarja amerikane e shtetit, Madeleine Albright, do të vijnë në Kosovë për të kremtuar së bashku me qytetarët 20-vjetorin e lirisë. Të pranishëm në këtë përvjetor jubilar do të jenë edhe personalitete të tjera ndërkombëtare




EPOKA E RE Shqipe HETEMI

**Prishtinë, 10 qershor** - Institucionet e Republikës së Kosovës tashmë i kanë bërë përgatitjet e nevojshme për shënimin e njëzetvjetorit të çlirimit. Të pranishëm në këtë përvjetor jubilar do të jenë ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Bill Clinton, ish-sekretarja amerikane e shtetit, Madelene Albright dhe personalitete të tjera ndërkombëtare.

Udhëheqësja e këshillit organizativ për shënimin e përvjetorit të lirisë, ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, të hënën ka mbajtur konferencë për medie, me ç'rast ka thënë se përmes shënimit të këtij 20-vjetori, Kosova po e nderon të kaluarën dhe vizionin e saj për paqe të qëndrueshme. Ajo ka treguar se tashmë është konfirmuar ardhja e miqve të mëdhenj të Kosovës, ish-presidentit Bill Cllinton dhe ish-sekretares së shtetit, Madeleine Albright. Po ashtu, Jahjaga ka bërë me dije se të ftuar do të jenë edhe miq të tjerë e personalitete politike nga vendi dhe rajoni. "Për të shënuar këtë përvjetor historik të Kosovës kemi ftuar miqtë dhe aleatë tanë me të cilët ndajmë vlerat e paqes, lirisë dhe demokracisë. Tashmë është bërë me dije se në këtë përvjetor historik të pranishëm do të jenë ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bill Clinton, ish-sekretarja e shtetit, Medeleine Albright dhe shumë personalitete të tjera të rëndësishme dhe miq të mëdhenj të Kosovës", ka deklaruar Jahjaga.

Me këtë rast ajo u ka bërë thirrje qytetarëve që të bëhen pjesë e manifestimit qendror që do të mbahet në Sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë, ku do të mbajnë fjalime Clintoni dhe Albrighti. "Të mërkurën në orën 11:00 në Sheshin 'Skënderbeu' do të mbahet tubimi qendror i shënimit të 20-vjetorit të hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë, ku do të flasin edhe presidenti Clinton dhe sekretarja Albright. Në këtë ngjarje ftojmë të jenë të pranishëm edhe qytetarët e Republikës së Kosovës në mënyrë që së bashku të festojmë me miqtë tanë këtë datë të rëndësishme për shtetin tonë. Në orën 14:00 do të nisë ecja për lirinë nga Sheshi 'Skënderbeu' deri te busti i sekretares Albright, i cili edhe do të përurohet. Për të vazhduar më pas me vizitën te shtatorja e presidentit Bill Clinton. Në përmbyllje të aktivitetit për shënimin e përvjetorit të lirisë në orën 17:00 do të mbahet konferenca ndërkombëtare e sigurisë. Është e rëndësishme që këto ngjarje t'i shënojmë së bashku me të gjithë qytetarët", ka theksuar ish-presidentja Jahjaga.

Ajo ka thënë se ideja për organizimin e 20-vjetorit të hyrjes së NATO-s në Kosovë kishte qenë e një ish-këshilltareje të saj, por që tani është projektuar si iniciativë e katër presidentëve të Republikës së Kosovës: Hashim Thaçit, Fatmir Sejdiut, Behgjet Pacollit dhe Atifete Jahjagës. "Kjo iniciativë është përkrahur nga Qeveria e Republikës së Kosovës e cila më 26 mars të këtij viti ka marrë vendim për themelimin e Këshillit Organizativ për shënimin e 20-vjetorit të hyrjes së NATO-s në Kosovë", është shprehur Jahjaga, duke shtuar se shënimi i këtij përvjetori duhet t'i bashkojë të gjithë përtej ndasive politike.

### AGJENDA PËR SHËNIMIN E 20-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË KOSOVËS

**11 QERSHOR**
**20:00-21:00** - Mbahet koncerti i Filarmonisë së Kosovës në Katedralen "Shën Nënë Tereza"

**12 QERSHOR**
**11:00-12:30** - Tubimi qendror i shënimit të 20-vjetorit të hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë në Sheshin 'Skënderbeu'

**14:00-14:30** - Ecje e personaliteteve të larta ndërkombëtare dhe vendore nga hoteli "Swiss Diamond" deri te busti i sekretares Albright

**14:35-14:50** Përurimi i bustit të sekretares Albright, Sheshi "Albright", afër "American School of Kosova"

**15:00-15:15** - Vizitë në bulevardin dhe afër shtatores së Bill Clintonit

**17:00-19:30** - Konferenca Ndërkombëtare e Sigurisë "20 vjet liri: një vizion për paqe të qëndrueshme".





## Haradinaj nderon shefin e shtabit të KFOR-it me hartën e artë të Kosovës

**Prishtinë, 10 qershor (ER)** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të hënën në takim lamtumirës shefin e shtabit të KFOR-it në vendin tonë, gjeneralbrigade John C. Boyd, të cilin e ka nderuar me Hartën e Artë të Kosovës. "Populli ynë do të jetë përjetë mirënjohës për kontributin e madh që ushtria dhe populli amerikan kanë dhënë dhe po japin për vendin. Për rolin e tij konstruktiv në shërbimin të paqes dhe bashkëpunimin profesional gjatë shërbimit në Kosovë, gjeneralin Boyd e nderova me Hartën e Artë të Kosovës", ka thënë Haradinaj pas takimit me gjeneralin amerikan.



Flet për "Epokën e re", Dhurata Hoxha

# Kërkojmë liberalizim sa më të



Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka bërë me dije se Qeveria e Kosovës është duke punuar maksimalisht që sa më shpejt çështja e liberalizmit të vizave të hyjë në agjendë të Këshillit të Bashkimit Evropian (BE). Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se derisa të sigurohet shumica e votave në Këshill të BE-së nuk do të hyjë kjo çështje në rend të ditës. Ministrja Hoxha ka thënë se nuk ka dilema rreth përkrahjes së Gjermanisë për liberalizimin e vizave për Kosovën por, sipas saj, konstituimi dhe lëvizjet pas zgjedhjeve dhe përbërjes së re të Parlamentit Evropian kërkojnë përmbushje të procedurave që kërkojnë kohë me ndikim në proces. Megjithatë, Hoxha ka thënë se Kosova kërkon liberalizim sa më të shpejtë të vizave për qytetarët e saj

EPOKA E RE Muhamet KOCI

**PRISHTINË, 10 QERSHOR** - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë se Republika e Kosovës kërkon liberalizim sa më të shpejtë të vizave për qytetarët e saj. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka bërë me dije se Qeveria e Kosovës është duke punuar maksimalisht që sa më shpejt çështja e liberalizmit të vizave të hyjë në agjendë të Këshillit të Bashkimit Evropian. Ministrja Hoxha ka thënë se derisa të sigurohet shumica e votave në Këshill të BE-së nuk do të hyjë kjo çështje në rend të ditës.

Ajo ka vlerësuar se konstituimi i institucioneve të BE-së pas zgjedhjeve kërkon pak kohë. "Nuk pres të hyjë në rend dite pa u siguruar shumica e votimit nga Këshilli i Ministrave të po atij rendi të ditës. Pra, pres që çështja të trajtohet por, fatkeqësisht, jo me dinamikën dhe nevojat tona. Qeveria dhe bartësit e përgjegjësive institucionale, të gjithë lobojmë vazhdimisht dhe rrahim në një pikë, se ne i kemi plotësuar të gjitha kriteret, andaj presim dhe kërkojmë vlerësim dhe liberalizim sa më të shpejtë të vizave për qytetarët tanë", ka thënë Hoxhaj. Ajo ka deklaruar se Gjermania e përkrah liberalizmin e vizave për qytetarët e Kosovës. "Nuk kemi dilema rreth përkrahjes së Gjermanisë, por konstituimi dhe lëvizjet pas zgjedhjeve dhe përbërjes së re të Parlamentit Evropian, kërkojnë përmbushje të procedurave që kërkojnë kohë me ndikim në proces", është shprehur ajo.

Ministrja e Integrimit Evropian ka folur edhe për raportin e fundit të Komisionit Evropian për Kosovën. Sipas Hoxhës, raporti evidenton arritje dhe sfidat që ka Kosova në rrugën e saj euroatlantike. "Raporti për vendin është proces tjetër, sepse flet për përafrimin tonë në rrugën integruese. Kemi arritje, por kemi sfida që duan të zgjidhen menjëherë. Ne kemi alarmuar shumë institucione për nivelin e ulët të përkushtimit dhe pikërisht ato edhe evidentohen. Punët tona ne duhet t'i kryejmë vetë. Ne kemi kapacitete që vetë t'i kryejmë punët tona në procesin integrues", ka thënë Hoxha. Ajo është shprehur e bindur se raporti i ardhshëm i Komisionit Evropian për Kosovën do të jetë shumë më pozitiv.

**"Epoka e re":** *Znj. Ministre, së bashku me kryeministrin Haradinaj sapo jeni kthyer nga vizita në Gjermani. Cila është mbështetja që morët nga ky vend për rrugën euroatlantike të Kosovës?*

**Hoxha:** Gjermania është vend mik, vend i fuqishëm donator për Kosovën dhe rajonin tonë. Vend mikpritës i mbi 400 mijë qytetarëve tanë dhe askush më mirë se ky vend mik nuk e njeh dëshirën dhe rrugën tonë të vendosur brenda vlerave euroatlantike. Rruga jonë euroatlantike është pa alternativë. Këtë e kemi konfirmuar dhe dëshmuar që nga çlirimi i vendit, madje që nga viti 1968, 1981 e këndej. Gjermania e rikonfirmon përkrahjen për zgjerimin e BE-së në gjashtë vendet e BE-së dhe ne jemi brenda çdo projekti pozitiv për rajonin.

**"Epoka e re":** *Po për procesin e liberalizimit të vizave, çfarë është qëndrimi i Gjermanisë?*

**Hoxha:** Përkrahja e Gjermanisë është e dëshmuar dhe objektive. Gjithsesi, qëndrimi i këtij vendi mik është i lidhur me frymën në Bashkimin Evropian,

# shpejtë të vizave për Kosovën



rrethanave jashtë ndikimit vendimtar gjerman. Nuk kemi dilema rreth përkrahjes së Gjermanisë, por konstituimi dhe lëvizjet pas zgjedhjeve dhe përbërjes së re të Parlamentit Evropian, kërkojnë përmbushje të procedurave që kërkojnë kohë me ndikim në proces.

**"Epoka e re":** *Kur pritni që çështja e liberalizmit të vizave për Kosovës të hyjë në agjendë të Këshillit të BE-së dhe çka po bën qeveria për të arritur këtë synim?*
**Hoxha:** Nuk pres të hyjë në rend dite pa u siguruar shumica e votimit nga Këshilli i Ministrave të po atij rendi të ditës. Pra, pres që çështja të trajtohet por, fatkeqësisht, jo me dinamikën dhe nevojat tona. Qeveria dhe bartësit e përgjegjësive institucionale, të gjithë lobojmë vazhdimisht dhe rrahim në një pikë, se ne i kemi plotësuar të gjitha kriteret, andaj presim dhe kërkojmë vlerësim dhe liberalizim sa më të shpejtë të vizave për qytetarët tanë.

**"Epoka e re":** *Komisioni Evropian ka publikuar raportin e fundit për Kosovën në të cilin janë evidentuar punët që janë bërë dhe sfidat me të cilat përballet Kosova. Sa jeni të kënaqur me këtë raport?*
**Hoxha:** Raporti për vendin është proces tjetër, sepse flet për përafrimin tonë në rrugën integruese. Kemi arritje, por kemi sfida që duan të zgjidhen menjëherë. Ne kemi alarmuar shumë institucione për nivelin e ulët të përkushtimit dhe pikërisht ato edhe evidentohen. Punët tona ne duhet t'i kryejmë vetë. Ne kemi kapacitete që vetë t'i kryejmë punët tona në procesin integrues.

**"Epoka e re":** *Pas publikimit të raportit të Komisionit Evropian është mbajtur edhe mbledhja e Këshillit Ndërministror për Integrime Evropiane. Cilat janë hapat që do t'i ndërmarrë Qeveria e Kosovës për t'i adresuar sfidat e këtij raporti?*
**Hoxha:** Hapat e parë janë dinamizimi i procesit, analiza e veprimeve afatshkurta, mënjanimi i çdo pengese për zbatimin e rekomandimeve. Ne nuk mund të mbesim peng të neglizhencës apo mospërkushtimit konform situatës dhe rekomandimeve të realizueshme nga Komisioni Evropian. Pritjet tona janë optimiste, sepse puna jonë do të jetë e pandalshme. Raporti tjetër duhet të jetë shumë më i mirë.



## Rekrutët e rinj të FSK-së fillojnë trajnimin bazik në Ferizaj

**Prishtinë, 10 qershor (ER)** - Në përputhje me planin gjithëpërfshirës të tranzicionit, Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës kanë filluar fushatën e rekrutimit për pjesëtarët e rinj të FSK-së. Pas disa proceduarve të rekrutimit, fazave testuese dhe seleksionuese të një numri mjaft të madh të konkurruesve, FSK-ja ka arritur të përzgjedhë 649 rekrutë, të cilët me sukses i kanë kaluar të gjitha këto faza. Ndërkaq të hënën në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, përkatësisht në Kazermën "Skënderbeu" në Ferizaj, ka filluar faza e parë e trajnimit për grupin e parë të rekrutëve prej 350 pjesëtarësh e cila do të zgjasë nëntë javë. Në kuadër të planit të trajnimeve, grupi i dytë i rekrutëve do ta fillojë trajnimin në muajin shtator, me qëllim të plotësimit të strukturës së FSK-së me personel të trajnuar dhe të gatshëm për ta përmbushur misionin dhe detyrat e FSK-së.

# Hoxhaj: Pika kufitare me Maqedoninë e Veriut lëshohet për qarkullim në fund të gushtit

**Prishtinë, 10 qershor (ER)** - Zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj, të hënën ka vizituar pikën kufitare me Maqedoninë e Veriut, Stanqiq-Bellanoc, ku së bashku me zëvendëskryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, kanë inspektuar punimet në ndërtimin e pikës doganore në këtë lokacion.
Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka falënderuar zëvendëskryeministrin Osmani për angazhimin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm për mbarëvajtjen e këtij projekti.
Zëvendëskryeministri ka thënë se këtë vizitë po e realizojnë në 20-vjetorin e tërheqjes së forcave serbe nga Kosova, krejt kjo me qëllim që t'i jepet kuptim simbolik kësaj pike kufitare që do t'i afrojë këto dy vende. "Sot është 10 qershori kur ne festojmë paraqitjen e Lidhjes së Prizrenit si një artikulim i kërkesave të shqiptarëve kudo që jetojnë. Sot është edhe 20-vjetori i miratimit të Rezolutës 1244 dhe tërheqjes së forcave serbe nga Kosova, prandaj kemi vendosur që kësaj dite simbolike t'ia japim një kuptim të ri me këtë pikë kufitare që do t'i afrojë vendet tona", është shprehur zëvendëskryeministri Hoxhaj. Ai ka paralajmëruar përfundimin e punimeve në këtë pikë në fund të muajit gusht, ndërsa hapjen për qarkullim të qytetarëve vetëm pas pak javësh. Po ashtu, zëvendëskryeministri Hoxhaj ka paralajmëruar se pika të reja kufitare do të ketë edhe me vende të tjera fqinje.



# Haradinaj kërkon njohjen nga Vatikani

EPOKA E RE Qendresa RAMA

Prishtinë, 10 qershor - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të hënën në takim sekretarin e Shtetit të Vatikanit, kardinalin Pietro Parolin. Të arriturat e vendit në aspektin politik dhe demokratik, pozicioni i Kosovës karshi vendeve të rajonit dhe bashkëpunimi ekonomik dhe diplomatik me këto vende, ishin disa prej temave të diskutimit në këtë takim. "Kosova është e përkushtuar ta vazhdojë avancimin e raporteve me Vatikanin dhe se njohja e shtetësisë së Kosovës nga Vatikani është hap i nevojshëm", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shtuar se vizita e kardinalit Parolin në Kosovë është dëshmi e përkushtimit të përbashkët për avancimin e marrëdhënieve bilaterale me shtetin e Vatikanit.

Haradinaj ka thënë se Kosova dhe populli i saj ndër shekuj kanë dëshmuar vlera euroatlantike për ruajtjen e paqes, stabilitetit dhe lirisë fetare në vend dhe këtë përkushtim ia ka shprehur edhe sekretarit Parolin, duke konfirmuar gatishmërinë për avancimin e këtij partneriteti edhe në të ardhmen.

Kryeministri Haradinaj përmendi edhe faktin se liria fetare dhe orientimi euroatlantik i Kosovës janë vlera të pacenueshme, vlera këto që duhet të promovohen edhe në raportet mes dy vendeve. "Shteti i Kosovës është faktor i rëndësishëm i paqes dhe i stabilitetit si dhe promovues i fqinjësisë së mirë", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shprehur mirënjohjen e popullit të Kosovës dhe qeverisë për përkrahjen e vazhdueshme të Selisë së Shenjtë dhënë Kosovës.

Sekretari i Shtetit të Vatikanit, kardinali Pietro Parolin, falënderoi kryeministrin Haradinaj për pritjen, derisa e inkurajoi popullin e Kosovës për paqe, pajtim dhe prosperitet me vendet fqinje dhe në rrugën e saj drejt integrimeve euroatlantike.

Takimi me sekretarin Parolin u zhvillua në Muzeun e Kosovës, një vit pas vizitës zyrtare që kryeministri Haradinaj i bëri Vatikanit, me ç'rast në Selinë e Shenjtë ishte pritur në takim nga Ati i Shenjtë, Papa



Françesku dhe Kardinali Pietro Parolin. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj në shenjë mirënjohje i ka dhuruar sekretarit të Shtetit të Vatikanit, Pietro Parolin, librin "Portrete të Skënderbeut gjatë shekujve", i botuar në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut.

# UP-ja shënon 20-vjetorin e çlirimit të Kosovës me konferencë shkencore




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Prishtinë, 10 qershor - Për nder të 20-vjetorit të çlirimit të Kosovës, Fakulteti Filozofik i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në bashkëpunim me Institutin Albanologjik të Kosovës, ka organizuar konferencën shkencore "Kosova, 20 vjet liri dhe përpjekje". Kjo konferencë, sipas rektorit të UP-së, prof. dr. Marjan Dema, paraqet aktivitetin e duhur akademik për ta shënuar 20-vjetorin e çlirimit tonë. "Universiteti i Prishtinës, që nga themelimi i tij, gati gjysmëshekulli më parë, është aktori kryesor në kthesat që e karakterizuan historinë e vendit tonë. Roli i Universitetit të Prishtinës në lëvizjet shoqërore në Kosovë ka qenë vital, meqë UP-ja ishte foleja prej nga filluan dhe u ngritën çështjet më madhore të kombit tonë në gjysmëshekullin e kaluar. Universiteti i Prishtinës doli në sipërfaqe për të ndërhyrë edhe në çështjet politike, pa të cilat ndërhyrje historia e kombit tonë shumë herë do të shkruhej ndryshe", ka thënë Dema.

Nikoqiri i kësaj konference, dekani i Fakultetit Filozofik, prof. dr. Bujar Dugolli, ka thënë se kjo konferencë do të ndihmojë në ndriçimin e çështjes së çlirimit të Kosovës. "Konferenca synon që studiuesve t'ua japë rastin që para audiencës t'i prezantojnë rezultatet shkencore pa paragjykime, pa konstruksione paraprake, pa ngjyrime të çfarëdo lloji qofshin ato, ashtu që të zbardhet procesi i mundimshëm për luftën çlirimtare të Kosovës dhe për çlirimin e saj", është shprehur Dugolli.

Punimet e konferencës "Kosova, 20 vjet liri dhe përpjekje", u përshëndeten edhe nga zëvendësministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Heset Sahiti, përfaqësuesi i diasporës shqiptare në ShBA, Xhevat Prespa, dhe drejtori i Institutit Albanologjik në Kosovë, prof. dr. Hysen Matoshi. Në këtë konferencë u prezantuan 39 kumtesa shkencore, të cilat do të botohen në revistën e Fakultetit Filozofik "Buletini shkencor".

## ShSKUK-ja mbështet funksionalizimin e dializës në Rahovec

Rahovec, 10 qershor (ER) - Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), dr. Basri Sejdiu, i shoqëruar nga drejtori i Spitalit të Përgjithshëm në Prizren, dr. Afrim Avdaj, kanë vizituar Komunën e Rahovecit. Në takim me kryetarin e komunës, Smajl Latifi dhe drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Samir Mustafa, kanë diskutuar për funksionalizimin e shërbimit të hemodializës në këtë komunë.

Drejtori Sejdiu ka ofruar mbështetjen dhe përkrahjen e ShSKUK-së për të funksionalizuar sa më shpejt shërbimin e dializës në këtë komunë, në mënyrë që pacientët e Komunës së Rahovecit të mos drejtohen për dializë në Spitalin e Prizrenit. Mjekët dhe infermierët e Spitalit të Prizrenit do të ndihmojnë në ofrimin e shërbimeve të dializës në këtë komunë.

Ky shërbim pritet të fillojë së shpejti.

Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajli Latifi dhe drejtori i Shëndetësisë, Samir Mustafa, kanë falënderuar drejtorin Sejdiu për përkrahjen e ofruar për funksionalizim të shpejtë të shërbimit të dializës në Rahovec.



Flet ish-zëdhënësi i NATO-s, Jamie Shea

# Marrëveshja ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit duhet ta përfshijë njohjen e Kosovës

Jamie Shea, i cili gjatë bombardimeve të NATO-s kundër Serbisë ishte zëdhënës i kësaj organizate, ka vlerësuar se këto bombardime, të cilat kanë ndodhur 20 vjet më parë, kanë qenë legjitime dhe të arsyeshme. Ai ka theksuar se pas fushatës brutale nga regjimi i Millosheviqit kundër shqiptarëve të Kosovës, NATO-ja nuk kishte zgjidhje tjetër përpos ta përdorte forcën kundër Serbisë. Jamie Shea në këtë intervistë dhënë për RTK-në ka theksuar se është e domosdoshme arritja e marrëveshjes në mes të Prishtinës dhe Beogradit, e cila, sipas tij, duhet ta përfshijë njohjen e Kosovës shtet i pavarur



PRISHTINË, 10 QERSHOR - Sivjet shënohet 20-vjetori i fushatës ajrore të NATO-s kundër caqeve të ushtrisë serbe, që solli përfundimin e luftës dhe vendosjen e trupave të NATO-s në Kosovë. Si i shihni nga kjo perspektivë ngjarjet e pranverës së vitit 1999?

Jamie Shea: Njëzet vjet pas fushatës ajrore të udhëhequr nga NATO-ja unë ende e konsideroj atë tërësisht legjitime dhe të arsyeshme. Regjimi i Millosheviqit në Serbi kishte udhëhequr një fushatë brutale kundër popullit të Kosovës duke bërë shkelje të shumëfishta të të drejtave të njeriut. Po ashtu, ka refuzuar një marrëveshje paqësore e të negociuar, të cilën e kishte pranuar delegacioni i Kosovës. Andaj, vendet anëtare të NATO-s nuk kishin zgjidhje tjetër pos ta përdornin forcën për t'i ndalur vuajtjet e popullatës civile të Kosovës. Për këtë veprim kemi pasur përkrahjen e publikut, parlamenteve dhe bashkësisë së gjerë ndërkombëtare, pasi ishte veprim proporcional dhe i qartë për arritjen e qëllimeve. Askush nuk dëshironte një përsëritje të asaj që ndodhi në Bosnje nga viti 1992 në 1995, kur bashkësia ndërkombëtare ishte shumë e ngadalshme për ndërmarrjen e veprimeve vendimtare.

*Fushata ajrore e NATO-s ka qenë intervenimi më i madh ushtarak në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore. Sa ka qenë e vështirë të binden vendet anëtare të NATO-s të marrin pjesë në këtë fushatë dhe të qëndrojnë të bashkuar përgjatë fushatës 78-ditëshe të bombardimeve?*

**Jamie Shea:** Askush nuk dëshiron ta përdorë forcën nëse mund të shmanget ajo. Për këtë arsye aleatët e NATO-s u përpoqën shumë për gjashtë muaj në Rambuje dhe Paris të negocionin një marrëveshje paqësore në mes të regjimit të Millosheviqit dhe përfaqësuesve të Kosovës. NATO-ja, po ashtu, disa herë e ka paralajmëruar publikisht dhe në mënyrë të qartë Millosheviqin të hiqte dorë nga fushata ushtarake e represionit në Kosovë. Kështu që, kur u mor vendimi në mars të vitit 1999 për përdorim force, aleatët ishin të bashkuar pasi të gjithë ishin të kënaqur që fushata ajrore me të vërtetë ishte mjeti i fundit dhe e justifikueshme si mënyra e vetme për ta ndalur spastrimin etnik që Millosheviqi po i bënte Kosovës. Pasi fillimit të fushatës ajrore, deportimi i dhunshëm masiv i popullatës së Kosovës dhe shumë raste të represionit të dhunshëm vetëm i bënë aleatët e NATO-s edhe më të vendosur që fushata ajrore të përfundonte me sukses të arritur. Aktakuza e ngritur nga OKB-ja ndaj Millosheviqit për krime lufte vetëm sa e përforcoi bindjen tonë se po bënim gjënë e duhur. Është vlerë e NATO-s që vendimet i merr me konsensus pas konsultimeve dhe planifikimeve në të cilat marrin pjesë dhe dëgjohet zëri i të gjithë aleatëve. Kështu që, kur Aleanca ndërmerr veprim, qëndron e bashkuar, pasi të gjithë aleatët janë hisedarë në veprimin e tyre kolektiv. Këtë e vërteton edhe fakti që forcat e NATO-s kanë qëndruar në Kosovë për ta siguruar stabilitetin në 20 vjetët e fundit.

*Si pjesëtar i personelit të NATO-s në atë kohë, e sot si profesor universitar, a mendoni se intervenimi i NATO-s është bërë pak me vonesë për ta parandaluar përndjekjen masive dhe vrasjen e mbi 13 500 njerëzve?*

**Jamie Shea:** Kjo është një pyetje e drejtë dhe është e qartë që secila vdekje e civilëve të pafajshëm është për t'u vajtuar. Por, krahasuar me 100 000 vrasjet në konfliktin e Bosnjës, targu i viktimave në Kosovë ishte rreth një e dhjeta e atij numri. Kjo tregoi se bashkësia ndërkombëtare kishte marrë mësim nga Bosnja kur bëhet fjalë për marrjen më të shpejtë dhe më të vendosur të veprimeve. Po ashtu, shumë vrasje ndodhën pas fillimit të fushatës ajrore të NATO-s kur forcat e Millosheviqit përshpejtuan veprimet e tyre të dhunshme kundër popullatës civile. Pasi u tha kjo, jam i bindur që po mos të intervenonte NATO-ja në Kosovë situata në terren do të përkeqësohej në mënyrë progresive dhe shkalla e vrasjeve do të ishte shumëfish më e lartë. Po ta shohësh Sirinë tani, me mbi gjysmë milioni të vrarë e gati 15 milionë njerëz të zhvendosur e me luftime që nuk u shihet fundi, mund të shihen që pasojat e mosintervenimit janë shumëfish më të këqija se kur bashkësia ndërkombëtare bën përpjekje serioze për t'i përfunduar luftërat. Një gjë tjetër shumë e rëndësishme është që fushata e NATO-s bëri të mundur kthim gati të menjëhershëm në shtëpi të qindra-mijëra refugjatëve nga Kosova. Kjo nuk ndodhi askund tjetër në ish-Jugosllavi e as në shumë konflikte të tjera në mbarë botën.

*Të kthehemi te zhvillimet aktuale. A mendoni se është e mundur një marrëveshje gjithëpërfshirëse në mes të Kosovës dhe Serbisë si dy shtete të pavarura?*

**Jamie Shea:** Po, është e mundur, por kërkon angazhim të vazhdueshëm të Shteteve të Bashkuara dhe të evropianëve për t'i shtyrë Prishtinën e Beogradin drejt një marrëveshjeje. Shpresoj se shoqëria civile si në Serbi ashtu edhe në Kosovë do t'i tejkalojnë ndarjet dhe do të punojnë për mirëkuptim më të madh dhe për pajtim. Të kuptuarit e historisë në mënyrë objektive është po ashtu kruciale. Kur po lexoja mediet e Serbisë në 20-vjetorin e fushatës ajrore të NATO-s u trondita nga sensi i viktimizimit dhe përjashtimi i çfarëdo përgjegjësie për atë që ndodhi në Kosovë më 1998-1999. 20-vjetori duhet të jetë një mundësi për të shikuar kah e ardhmja e jo kah e kaluara. Është e qartë që, mbi të gjitha, nevojitet një marrëveshje në mes të Prishtinës dhe Beogradit, që patjetër duhet ta përfshijë njohjen e Kosovës si shtet i pavarur. Kjo duhet të jetë element i domosdoshëm i perspektivës evropiane për Kosovën dhe Serbinë, që njëherësh nxit integrimin euroatlantik të të gjithë Ballkanit Perëndimor.

*A mendoni që në një të ardhme të afërt shtetet e Ballkanit Perëndimor do të bëhen anëtare të aleancës së NATO-s?*

**Jamie Shea:** Mendoj se po. Nuk do të ndodhë aq shpejt sa dua unë, por do të ndodhë. Shembujt e Malit të Zi dhe të Maqedonisë Veriore tregojnë se dera e NATO-s është e hapur. Përjashtim përbën Serbia që aktualisht nuk kërkon anëtarësim në NATO, por që është duke negociuar hyrjen në BE. Andaj është në rrugë për t'u bërë vend i vërtetë evropian dhe është duke bashkëpunuar me Aleancën në shumë stërvitje të përbashkëta dhe në kurse trajnuese. E në afat të gjatë, kurrë s'duhet thënë kurrë!

**(Intervistoi: Afet BELA, RTKlive)**

# Shyqyri Haxha: Kontrata me 'Z-Mobile' ishte kryer para se unë të vija kryeshef i PTK-së

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Ish-kryeshefi i Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK), Shyqyri Haxha, ka raportuar të hënën para komisionit hetimor të PTK-së. Ai para anëtarëve, deputetë të këtij komisioni, ka theksuar se në kohën kur kishte ardhur në krye të PTK-së kontrata me "Z-Mobile" ka qenë punë e kryer. "Çdo gjë ka nisur tri vjet para se të vij unë. Kur kam ardhur unë çdo gjë ka qenë e përfunduar, me procedurë të tenderimit dhe të gjitha. Është hera e parë në Kosovë që kontrata negociohet bashkë me bordin dhe menaxhmentin. Në këtë rast çdo gjë ka qenë e përfunduar. Kur kam ardhur në Kosovë nuk kam njohur asnjë njeri. Të parët që i kam takuar kanë qenë anëtarët e bordit. Kam ardhur nga një vend ku respektohet ligji", ka thënë Haxha.

Ai ka theksuar se sa ishte kryeshef i PTK-së ishte kërcënuar me vdekje në plot raste dhe ka treguar se kishte larguar nga puna 50 persona për krim të organizuar në PTK-ja. "Tri herë jam kërcënuar me vdekje. Kur kam kërkuar largimin e antenave serbe jam kërcënuar me vdekje. I kam shkarkuar drejtorët, nuk kam bërë kompromis. Me të gjithë politikanët që jam takuar u kam thënë se nuk lejoj të dëmtohet kompania. Kjo kontratë ka qenë e nënshkruar. Nëse e shikoni vendimin e bordit thotë kështu: Bordi me shumicë votash e ka miratuar. Nuk thotë për ta nënshkruar, por për ta implementuar. Nuk ka mundur njeri i gjallë për ta ndalur atë kontratë", ka thënë Haxha. Sipas tij, kontrata me "Z-Mobile" është përdorur si biletë për të hyrë në PTK dhe për ta bluar PTK-në. "'Z Mobile' iu ka ikur pagesave dhe nuk e ka zbatuar kontratën. Sikur faktet që i kam unë, po të ishin përdorur në Arbitrazh, do të humbte 'Z Mobile' dhe do ta kompensonte PTK-në për humbjet e bëra. 'Z Mobile' pagesat nuk i ka bërë me kohë. E kam detyruar ta shkruajë një aneks kontratë që për çdo tender do të duhej të merrej aprovimi i PTK-së", ka thënë ai.

Haxha ka treguar se ka kërkuar rreth 20 takime për ta ndalur këtë kontratë. "Bordi më ka thënë se nuk mund ta ndalesh. Kam qenë vetëm dhe është dashur të ballafaqohem me të. Unë nuk kam mundur të tërhiqem", ka thënë ai. Sa iu përket punësimeve në PTK, Haxha ka thënë se ka punësuar vetëm tre persona, kurse ka drejtuar akuza për disa punësime nga njerëz të politikës.



# Matoshi kërkon nga Hamza plotësim-ndryshimin e Ligjit për taksën ekologjike

PRISHTINË, 10 QERSHOR (ER) - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka pritur të hënën në takim ministrin e Financave, Bedri Hamza, me të cilin kanë diskutuar në lidhje me agjendën legjislative, projektet kapitale mjedisore si dhe ligjin për taksën rrugore dhe ekologjike. Në takim ministri Matoshi ka falënderuar ministrin Hamza për angazhimin e Ministrisë së Financave për kryerjen e procedurave që lidhen me vlerësimet financiare për projektligjet që sponsorizon Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Në lidhje me këtë Matoshi ka kërkuar përkrahjen e ministrit Hamza që edhe më tej ta përkrahë MMPH-në në shtyrjen përpara të agjendës legjislative për ta plotësuar kështu me kohë planin legjislativ 2019. Ministri Matoshi, po ashtu, ka kërkuar nga ministri Hamza fillimin e procedurave për plotësim-ndryshimin e ligjit për taksën rrugore dhe ekologjike. "Ligji aktual për Taksën Rrugore dhe Ekologjike për Automjete kategorizon veturat vetëm në bazë të peshës sa i përket nivelit të pagesës, ku veturat deri në 3.5 tonë paguajnë taksë ekologjike 10 euro, kurse veturat mbi 3.5 tonë paguajnë shumën prej 30 eurosh. Sipas këtij ligji, taksa ekologjike ka për qëllim ngritjen e cilësisë së mbrojtjes së ambientit, andaj pagesa për këtë taksë duhet të bëhet në proporcion me dëmin që shkaktojnë veturat në mjedis", ka thënë Matoshi, duke shtuar se ligji aktual në aspektin e pagesës i trajton të gjitha veturat njëjtë duke përfshirë ato hibride dhe elektrike, të cilat janë më miqësore me mjedisin dhe, si të tilla, duhet të kenë lehtësira në nivelin e pagesës për taksën ekologjike. "Rishikimi i këtij ligji dhe harmonizimi me parimet dhe politikat progresive mjedisore do të ndikojë në përmirësimin e gjendjes së mjedisit dhe zhvillimin e ekonomisë së gjelbër në shtetin tonë", ka vlerësuar ministri Matoshi. Në lidhje me këtë iniciativë të ministrit Matoshi, ministri Hamza ka deklaruar që do të mbështesë këtë iniciativë dhe ky plotësim-ndryshim i këtij ligji do të futet në planin legjislativ të vitit 2020.



# Shala: Akreditimi kontribuon në zhvillimin ekonomik

EPOKA E RE A. MAVRAJ



PRISHTINË, 10 QERSHOR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, me rastin e Ditës Botërore të Akreditimit, ka thënë se akreditimi, por edhe standardizimi dhe metrologjia, kontribuojnë në zhvillimin ekonomik përmes reduktimit të kostove të tregtisë dhe të bërit biznes. "Dita Botërore e Akreditimit thekson rolin e akreditimit në shtimin e vlerës në zinxhirët e furnizimit. Akreditimi, së bashku me shtyllat e tjera të infrastrukturës së cilësisë, siç janë standardizimi dhe metrologjia, janë një mjet i pranuar gjerësisht që kontribuon në zhvillimin ekonomik përmes reduktimit të kostove të tregtisë dhe të bërit biznes, duke mundësuar integrimin e bizneseve në zinxhirët globalë të furnizimit si dhe në ngritjen e besimit në mes të partnerëve në biznes", ka thënë ministri Shala. Sipas Shalës, zhvillimi ekonomik në përgjithësi dhe zhvillimi i sektorëve të infrastrukturës së cilësisë në veçanti janë ndër sfidat kryesore me të cilat përballet Kosova. "Adresimi i këtyre sfidave është prioriteti im gjatë këtij mandati qeverisës në krye të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. MTI-ja është e përkushtuar të ndërtojë dhe zhvillojë një sistem efikas, të qëndrueshëm dhe në përputhje me praktikat e mira në ngritjen e infrastrukturës së cilësisë dhe sektorëve të tjerë të cilët kanë impakt në ekonomi. Ne po punojmë për vendosjen e drejtë të kritereve dhe standardeve teknike për produkte dhe shërbime, të përcaktuara me marrëveshje tregtare dhe legjislacion të harmonizuar të BE-se si dhe krijimin e mekanizmave adekuatë dhe me kompetencë për zbatimin e tyre. Kjo do ta mundësojë ngritjen e konkurrueshmërisë në tregun vendor dhe të jashtëm, eliminimin e barrierave tregtare, ta sigurojë mbrojtjen e jetës dhe shëndetit për konsumatorin si dhe të ofrojë një mjedis më të sigurt duke u bërë pjesë e integruar e organeve ndërkombëtare", ka thënë Shala.

Ai ka bërë me dije se fusha e akreditimit është përfshirë si një ndër komponentët kryesorë në projektin konkurrueshmëria dhe gatishmëria për eksport, projekt i cili realizohet në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe që ka një vlerë prej 14.3 milionë eurosh. Shala ka shtuar se me këtë synojnë të krijohet Qendra Kombëtare e Cilësisë. "Fusha e akreditimit është përfshirë si një ndër komponentët kryesor në projektin konkurrueshmëria dhe gatishmëria për eksport, projekt i cili realizohet në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe që ka një vlerë prej 14.3 milionë eurosh. Ky projekt, ndër të tjera, ka për qëllim mbështetjen e zhvillimit dhe njohjes ndërkombëtare të infrastrukturës së cilësisë në përgjithësi dhe të akreditimit në veçanti. Me këtë synojmë ta krijojmë Qendrën Kombëtare të Cilësisë", ka thënë Shala.

Ai ka theksuar se në përmbushje të obligimeve që rrjedhin nga MSA-ja kanë punuar për harmonizimin e legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian. "Në përmbushje të obligimeve që rrjedhin nga neni 80 i MSA-së, kemi punuar për harmonizimin e legjislacionit të Kosovës me atë të Bashkimit Evropian, duke kompletuar infrastrukturën ligjore të akreditimit, konkretisht hartimin e katër akteve nënligjore që derivojnë nga Ligji i Akreditimit. Gjithashtu, kemi formuar task-forcën për koordinimin e aktiviteteve ligjore dhe teknike për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare të akreditimit, standardizimit dhe metrologjisë", ka thënë ministri Shala.

Shala ka përmendur hapat që kanë ndërmarrë sa iu përket lehtësirave për bizneset dhe mbrojtjen e konsumatorëve. "Në drejtim të krijimit të lehtësirave për biznese, në këtë rast për TVK-vë që operojnë në Kosovë, është hartuar politika e gjurmueshmërisë së matjeve me të cilën pranohen certifikatat e kalibrimit të lëshuara nga AMK-ja për masë, termometri dhe volumi. Kjo mundëson që TVK-të t'i kryejnë shërbimet e kalibrimit për fushat e lartcekura brenda Kosovës më shpejt, më lehtë dhe me shpenzime më të vogla. Në kuadër të politikave për përmirësimin e infrastrukturës së cilësisë, me theks të veçantë mbrojtjen dhe sigurinë e konsumatorëve, kemi hartuar Ligjin për produktet e ndërtimit, i cili përcakton kushtet dhe rregullat për vendosjen në treg të produkteve të ndërtimit", ka thënë Shala.

# Beqaj: Synojmë krijimin e punësimit përmes ngritjes së aftësive eksportuese




PRISHTINË, 10 QERSHOR (ER) - Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka marrë pjesë në ceremoninë e shpërndarjes së certifikatave për 65 profesionistët e rinj, të cilët janë certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare për CNC operatorë, automatizim të industrisë dhe efiçienca në energji. Me këtë rast, ministri Beqaj ka thënë se krijimi i vendeve të reja të punës, përmes promovimit të eksportit, është në fokusin e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. "Kjo është forma më e mirë e bashkëpunimit strategjik në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Gjermanisë, në fushën e përgatitjes së kuadrove të reja për tregun e punës", është shprehur Beqaj.

Ai ka thënë se Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, së bashku me GIZ-in, nëpërmjet projektit CETEP po i përgatisin kuadrat e reja për të punuar dhe qëndruar në Kosovë. "Projekti CETEP është projekt për krijimin e punësimit përmes ngritjes së aftësive eksportuese. Këta sektorë ku janë aftësuar 65 profesionistë janë të kërkueshëm në treg. Prandaj, t'i përgatisim këta njerëz për të qëndruar në Kosovë dhe për t'u bërë pjesë e ekonomisë dhe rritjes së potencialit për eksport", ka thënë ai.

Beqaj ka bërë me dije se kanë nisur procedurat edhe për projektin CETEP Pus, i cili, sipas tij, do të ofrojë më shumë mundësi e fonde për përkrahjen e projekteve të ndryshme. Projekti CETEP është bashkëfinancim i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe GIZ-it.

# Bahtiri: Shalianët janë shquar për mençuri dhe trimëri

MITROVICË, 10 QERSHOR (ER) - Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, është organizuar akademi përkujtimore në shenjë nderimi për përvjetorin e 20 të rënies së martirëve të kombit në fshatin Vllahi të kësaj komune. Me këtë rast, kryetari Bahtiri ka vendosur buqeta me lule pranë varrezave të martirëve të fshatit Vllahi, duke i nderuar kështu dëshmorët për veprën dhe sakrificën e tyre për t'i sjellë atdheut lirinë.
Në fjalën e tij, kryetari Bahtiri ka thënë se Shala ndër vite është shquar për luftëtarë trima e të zotë të cilët janë pjesë e historisë së vendit tonë. "Çdo herë Shala ka qenë vendi i cili ka treguar se ka njerëz të cilët kanë qenë të gatshëm ta japin jetën për vendin e tyre dhe i kanë dalë zot çdoherë atdheut. Shalianët ndër vite janë shquar për mençuri dhe trimëri, për çka ne të gjithë duhet të krenohemi me veprën e këtyre martirëve, të cilët luftuan për liri dhe pavarësi të vendit", ka thënë kryetari Bahtiri.
Ndërsa Shukri Begu, familjar i martirëve, ka thënë se sakrifica dhe gjaku i dëshmorëve ka bërë që Kosova të jetë këtu ku është tani. Në anën tjetër, përfaqësuesi i fshatit Vllahi, Ramadan Ademi, ka falënderuar krerët komunalë për pjesëmarrjen e tyre në këtë akademi, i cili, në shenjë respekti, ka ndarë mirënjohje për kryetarin Bahtiri, nënkryetarin Faruk Mujka, kryesuesin e Kuvendit Komunal, Safet Kamberi dhe për drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci.





# Nënshkruhet kontrata për zgjerimin e hyrjes dhe urës së Veternikut

PRISHTINË, 10 QERSHOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, të hënën ka nënshkruar kontratën për zgjerimin e rrugës nacionale N2, segmenti hyrja në qytetin e Prishtinës nga ana e Veternikut, bashkë me urën që i lidhë rrugët nacionale N2 dhe N25.2, me kyçjen e autostradës R7 "Ibrahim Rugova". Ky projekt është tejet i rëndësishëm për këtë zonë të mbingarkuar nga komunikacioni, nga frekuentimi i madh i veturave që hyjnë dhe dalin në kryeqytet, por edhe lidhen me vende të tjera. Projekti me vlerë mbi 2.5 milionë euro do të fillojë në fund të muajit qershor dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit është e përkushtuar që të zhvillohet sipas planit dinamik të punimeve, duke evituar çfarëdo vonese në përfundim të punimeve me kohë.

# Nisin aktivitetet për shënimin e 141-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

PRIZREN, 10 QERSHOR (ER) - Me organizimin e orës letrare për fëmijë "Ditët e Lidhjes", të hënën kanë filluar aktivitetet të cilat do të organizohen nga Komuna e Prizrenit me rastin e 141-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.
Ora letrare është organizuar në oborrin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ndërsa në prani të kryetarit të Prizrenit, Mytaher Haskuka, zyrtarëve komunalë, nxënësve nga shkollat fillore dhe poetëve e shkrimtarëve të ndryshëm, janë recituar poezi të shumta për fëmijë. Ora letrare ka vazhduar me poezitë për të rritur, si dhe është mbajtur koncerti muzikor "Nostalgjia" me performancë të artistëve Agim Gërguri, Osman Shehu dhe Agim Tejeci. Ndërsa turneu i futbollit dhe i basketbollit i paralajmëruar për të hënën do të organizohet më 12 qershor nga ora 10:00.



# Komuna e Malishevës bëhet gati për shënimin e Ditës së Çlirimit

MALISHEVË, 10 QERSHOR - Përgatitjet për shënimin e 20-vjetorit të çlirimit të Malishevës janë duke vazhduar, ndërsa aktivitete të ndryshme do të zhvillohen gjatë tërë kësaj jave. Kështu është thënë në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve në Komunën e Malishevës, e cila është drejtuar nga kryetari Ragip Begaj.
Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Besartë Kryeziu-Ramaj, gjatë raportimit në këtë mbledhje ka deklaruar se gjatë tërë javës do të ketë aktivitete të ndryshme, kulturore dhe sportive, në kuadër të shënimit të 16 qershorit - Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës. Sipas saj, aktivitetet kryesore do të mbahen të dielën më 16 qershor, të cilat do të fillojnë me pritjet në zyrën e kryetarit, pastaj përurimin e kompleksit memorial të masakrës së Burimit, për të vazhduar me mbledhjen solemne, i cili është aktiviteti kryesor, pastaj me homazhe dhe nderime në vendet me rëndësi historike të luftës së UÇK-së, për të përfunduar me koncertin tradicional në qendër të qytetit dhe me ndezjen e fishekzjarrëve.
Po në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve përgjegjësit e drejtorive komunale kanë raportuar për aktivitetet e tyre, ku është bërë me dije se gjatë javës pritet të përfundojnë procedurat për shumë projekte kapitale, pastaj përgatitjet për mbajtjen e testit të maturës, përfundimi i vitit shkollor dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ardhshëm shkollor, përkatësisht për regjistrimin e nxënësve në klasat e dhjeta dhe klasat e para. Sa i përket situatës epidemiologjike me EHKK-në, drejtoritë përkatëse kanë theksuar se janë duke vazhduar fushatën e dezinsektimit dhe, pavarësisht prej rasteve të thumbimeve, nuk ka asnjë rast të infektuar nga EHKK-ja.



# Bashkimin me Shqipërinë e pamundëson Kushtetuta e Kosovës dhe jo BE-ja

*Aspirata më e madhe e kombit shqiptar ishte dhe mbetet bashkimi i shtetit shqiptar, ndërsa mosgatishmëria e klasës politike të Kosovës, për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, është krejtësisht përgjegjësi e saj dhe aspak e BE-së*



Ismet HAJRULLAHU

Deklarata e kryeministrit shqiptar Edi Rama, që Kosova mund t'i bashkohet Shqipërisë, nuk është aspak provokuese, por është krejtësisht në përputhje me aspiratat e ligjshme të popullit shqiptar dhe në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë flet që në preambulën e saj "për aspiratën shekullore të popullit shqiptar, për identitetin dhe bashkimin kombëtar".

Ndonëse në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë, kjo deklaratë, nga ana tjetër, është ne kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, e cila e pamundëson një gjë të tillë e specifikuar në Nenin 1 pika 3 të Kushtetutës që thotë: "Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë shteti ose pjese të ndonjë shteti dhe nuk do të kërkojë të bashkohet me asnjë shtet ose pjesë të ndonjë shteti". Për më keq, Kushtetuta nuk mund të ndryshohet pa 2/3 e deputetëve të pakicave, si dhe një sërë ligjesh të rëndësishme nuk mund të ndryshohen pa 1/2 e deputetëve të pakicave!

Nisur nga këto fakte thelbësore kushtetuese, lind pyetja: kush është kundër Bashkimit me Shqipërinë, Kushtetua e miratuar nga vetë të zgjedhurit e popullit të Kosovës, apo BE-ja?!

Për hir të së vërtetës, duhet thënë se shqiptarët në dy anët e kufirit (e që edhe sot pa ndonjë ndryshim me të kaluarën, ngel një kufi i dhunshëm), u përpoqën pas Lidhjes së Prizrenit edhe pas Pavarësisë së shtetit shqiptar, në kushte shumë herë më të vështira, për bashkimin e Shqipërisë; populli shqiptar ne Kosove nëpërmjet organizatave politike ilegale të kohës, si dhe shteti i Shqipërisë, që në vazhdimësi e ka shprehur dhe mbështetur domosdoshmërinë e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, ndonëse konjukturat e kohës dhe raporti i forcave nuk lejonin veprime më të dukshme.

Rikujtojmë këtu se Plani Sekret i vitit 1980, për çlirimin e Kosovës, nën emrin e koduar "Shpërthimi". Edhe pse ky plan nuk u arrit të funksonalizohej, megjithatë është fakt shumë domethënës, sepse është tepër i rëndësishëm në historinë e përpjekjeve të shtetit shqiptar për të bashkuar Shqipërinë.

Pavarësisht zërave të shterur kundër bashkimit të Shqipërisë, zëra që vijnë nga skutat me të errëta, aspirata më e madhe kombit shqiptar ishte dhe mbetët bashkimi i shtetit shqiptar, ndërsa mosgatishmëria e klasës politike të Kosovës për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, është krejtësisht përgjegjësi e saj dhe aspak e BE-së.

Mosliberalizimi i vizave, nuk është tregues se Bashkimi Evropian është kundër bashkimit të Shqipërisë. Me liberalizimin e vizave dhe me anëtarësimin e Kosovës në BE, nuk zgjidhet çështja shqiptare e as problemet e mëdha sociale, ekonomike të qytetarëve të Kosovës. Këtë e argumenton rasti i Bullgarisë dhe Rumanisë që është një shembull se edhe pas kaq shumë vitesh anëtarësimi, ato ngelen dy shtetet më të pazhvilluara të BE-së.

Vullneti i anëtarësimit i Kosovës në Bashkimin Evropian, është i madh, por ky fakt nuk duhet të vë në pikëpyetje vullnetin e shqiptarëve për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Me një fjalë, nëse nuk kemi klleqe për të bashkuar shtetin në formën e bashkimit të Gjermanisë, pasi e ndalon edhe kushtetua dhe ndryshimin e saj e pamundësojnë 2/3 e deputetëve të pakicave Kosovës, atëherë mund të organizohet një referendum për të pyetur popullin se çfarë dëshiron:

1. Të jetojë në dy shtete të ndryshme, Shqipëri dhe Kosovë; apo
2. Të jetojë në një shtet të vetëm shqiptar.

Nëse BE-ja, është e interesuar që në Ballkan të ketë paqe, ajo arrihet vetëm duke baraspeshuar forcat shqiptare dhe ato serbe. Ky baraspeshim mund të arrihet vetëm nëse Kosova do i bashkohej Shqipërisë. Në të kundërt, Serbia si një shtet me mbështetjen e pakufishme të Rusisë ekspansioniste, do ta ndjejë veten superiore, dhe si rrjedhojë stabiliteti Ballkanit, por edhe ai i Bashkimit Evropian, do të ngelin në mëshirën e Serbisë!

Përfundimisht, ashtu siç edhe dihet, shqiptarët janë ndër kontribuuesit dhe mbrojtësit më të mëdhenj të civilizimit evropian; prandaj si të tillë, nuk e meritojnë të jenë një komb i ndarë në dy shtete, e për pasojë, të mbesin më të varfrit e Evropës.

**(Ky shkrim është publikuar në vitin 2015 në disa media të shkruara në Kosovë)**

Shkrim drejtuar gazetarëve dhe atyre që merren me politikë

# Gjenocidi, termi 'asgjësim' dhe Kodi Penal i Kosovës



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

Përkufizimi i gjenocidit në Kodin Penal të Republikës së Kosovës është përkthim nga gjuha serbe dhe është i pasaktë. Në dy shkrimet paraprake trajtova përdorimin e gabueshëm të termeve "zhdukje" dhe "shfarosje" kur bëhet bartja kuptimore që këto terme kanë në gjuhën e zakonshme dhe emërohen kategori të caktuara të së drejtës penale ndërkombëtare.

Edhe termi "asgjësim", si sinonim i "zhdukjes" dhe i "shfarosjes", i cili ka kuptimin e veprimit që "e shkatërron krejt, e prish që të mos jetë më, e shfaros, e zhduk diçka", ka zënë një vend të rëndësishëm jo vetëm në gjuhën e përditshme të politikanëve, por edhe në dokumentet zyrtare të shtetit të Kosovës.

Gjuhët me prejardhje latine, dhe nën ndikimin e tyre, edhe gjuha angleze, për fjalën "asgjësim" përdorin fjalën "annihiler" (frëngjisht), "annientare" (italisht), "annihilate" (anglisht) e që kanë prejardhje nga fjala latine "annihilare" (të bësh të mos ekzistojë diçka, ta shkatërrosh tërësisht). Ndërsa për veprimin që shkatërron tërësisht diçka, që e asgjëson, në gjuhën ruse përdoret fjala "??????????", në serbisht "uništenje".

Në përkthimet në gjuhën angleze, frënge, italiane të Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit dhe Statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare, në asnjë rast nuk përdoret termi asgjësim ("annihilate", "annihiler", "annientare"), por përdoret termi "shkatërrim" ("destroy", "détruire", "distruggere").

Edhe në gjuhën gjermane në dokumentet e lartpërmendura nuk përdoret folja "vernichten" (asgjësoj), por folja "zerstören" (shkatërroj). Ndërsa në gjuhën ruse dhe serbe, në përkufizimin e gjenocidit,në vend të fjalës "shkatërrim" përdoret fjala asgjësim (në rusisht "??????????", në serbisht "uništenje").

Përmendja e terminologjisë ruse dhe serbe është e domosdoshme, për arsye se një numër i juristëve shqiptarë janë nën ndikimin e terminologjisë së shkollave juridike të Rusisë dhe të Serbisë.

Duke u nisur nga fakti se krimet që përfshihen në kuadër të së drejtës penale ndërkombëtare janë krime me të cilat preokupohet mbarë njerëzimi, shumica e shteteve kanë përfshirë në kodet e tyre penale masat përkatëse për të ndëshkuar ata që kanë qenë të implikuar në këto krime, ose që mohojnë krimin e gjenocidit, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës.

Në funksion të këtyre masave edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Kodin Penal të Republikës së Kosovës, në të cilën përfshihen dënimet për veprat e lartpërmendura penale.

Fatkeqësisht në Kodin Penal të Republikës së Kosovës terminologjia lidhur me këto krime nuk është e saktë dhe si e tillë është e dëmshme, sepse krijon mundësinë e interpretimeve jo të drejta kur kemi të bëjmë me gjenocidin.

Në Kapitullin XV të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, kapitull i titulluar "Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare, nenin 148 i kushtohet krimit të gjenocidit. Përkufizimi i gjenocidit është me sa vijon: "1. Kushdo që me qëllim të asgjësimit të tërësishëm apo të pjesërishëm të ndonjë grupi kombëtar, etnik, racor apo fetar kryen një ose më shumë nga veprimet e mëposhtme, do të dënohet me burgim së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet ose me burgim të përjetshëm: 1.1. vrasjen e anëtarëve të grupit; 1.2. shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore apo mendore të anëtarëve të grupit; 1.3. vënien e qëllimshme të grupit në kushte të tilla të jetës të cilat shpijnë në shfarosje të plotë apo të pjesërishme fizike; 1.4. vënien e masave të cilat kanë për qëllim që të pengojnë lindjet brenda grupit; 1.5. transferimin me dhunë të fëmijëve të grupit në një grup tjetër".

Kushdo që bën një analizë krahasuese të përkthimeve të Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit dhe Statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare do të bindet se përkufizimi i gjenocidit në Kodin Penal të Republikës së Kosovës është përkthim nga gjuha serbe.

Në doracakun që mendoj ta publikoj lidhur me këtë terminologji do t'i citoj përkufizimet në gjuhen angleze, frënge, italiane, gjermane, ruse dhe serbe, sepse vetëm në këtë kontekst do të kuptohet drejtë se përdorimi i gabueshëm i një kategorie juridike hap rrugën për interpretime të gabueshme të krimit të gjenocidit.

As termi "zhdukje" dhe as termi "asgjësim" nuk janë kategori juridike të së drejtës penale ndërkombëtare.

Në nenin II të Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit dhe në Nenin 7 të Statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare gjenocidi përkufizohet si krim kur një ose më shumë nga aktet kriminale të numëruara në këto nene kryhen me qëllim që të shkatërrohet tërësisht ose pjesërisht një grup kombëtar, etnik, racor ose fetar, si i tillë.

Serbisë, që ka kryer gjenocid në Kosovë, dhe atyre që mohojnë këtë gjenocid u intereson që në përkufizimin e gjenocidit të mbeten në përdorim termet "zhdukje" dhe "asgjësim", sepse, sipas kësaj logjike, fakti që nuk jemi "zhdukur" dhe nuk jemi "asgjësuar" do të përdorej si "argument" se gjoja nuk është kryer gjenocid ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Konsideroj se Kuvendi i Kosovës duhet të bëjë korrigjimin e terminologjisë së gabueshme në Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe ta harmonizojë me konceptet juridike adekuate.

Intervistë me autoren e librit "Bleibende Spuren", Basrie Sakiri-Murati

# 'Bleibende Spuren', përfaqëson fatin e mijëra shqiptarëve



EPOKA E RE **Lulëzim ETEMAJ**

PRISHTINË, 10 QERSHOR - Këto ditë Shtëpia Botuese "Rotpunktverlag", një nga shtëpitë botuese më prestigjioze në Zvicër, e ka botuar librin me kujtime të shqiptares së Kosovës, Basrie Sakiri-Murati, "Bleibende Spuren". Autorja e librit është veprimtarja e dalluar politike, ish-pjesëtare e "Çetës së Llapit", e njohur si "Shqipja".

Në intervistën që e zhvilluam për gazetën "Epoka e re", Basrie Sakiri-Murati, krahas të tjerash, tregon motivin prijës për ta botuar librin në gjuhën gjermane; shpjegon përmbajtjen e librit; çfarë konkretisht u ofron lexuesve gjermanofonë, posaçërisht atyre




shqiptarë, të lindur në mërgim; jetën e saj mes dy botëve, dy kulturave. Me këtë rast, autorja i hedh një shikim të veçantë, nga këndvështrimi i sotëm, gjimnazistes, pjesëtares së Lëvizjes Kombëtare Çlirimtare të Kosovës, "Shqipes" së "Çetës së Llapit", angazhimeve politike atdhetare, ëndrrave dhe idealit të saj dhe të bashkëveprimtarëve të saj.

*Cili ka qenë motivi juaj bazë kur keni vendosur t'ia ofroni lexuesit gjermanofon gjurmët e pashlyeshme ("Bleibende Spuren") të një shqiptareje të Kosovës?*

**Basrie Sakiri-Murati:** Njeriu me sjelljen dhe veprën e tij e reflekton jo vetëm vetveten, por edhe familjen, shoqërinë dhe atdheun e tij. Qëllimi im ishte që lexuesit gjermanofon jo vetëm t'i ofroj ngjarje të jashtëzakonshme nga e kaluara ime, por edhe ta informoj se çfarë përjetuam ndër vite me radhë nën një pushtues siç ishte Serbia. Janë vetë reagimet pozitive të lexuesve të "Gjurmë të pashlyeshme…", si dhe interesimi i miqve zviceranë për ta lexuar librin tim, që më shtynë t'i përvishem punës dhe përktheva "Gjurmë të pashlyeshme…" në gjermanisht. Shtëpia Botuese e mirënjohur "Rotpunktverlag" në Zürich më ofroi mundësinë ta botoj librin, kështu që në prillin e vitit të kaluar fillova së shkruari vazhdimin e "Gjurmë të pashlyeshme…", i cili tani është në duar të lexuesit me titullin "Bleibende Spuren" (Gjurmë të përhershme).

*Libri përmban dy pjesë. Çfarë i ofroni lexuesit në pjesën e parë dhe në të dytën?*

**Basrie Sakiri-Murati:** Në pjesën e parë e përshkruaj jetën time dhe aktivitetet e mia si dhe bashkëveprimtarëve në Kosovë. Si e re u aktivizova herët në veprimtarinë atdhetare, e frymëzuar nga familja dhe rrethi shoqëror. Në fund të viteve 1980, atëkohë gjimnaziste, isha e angazhuar që të jap kontributin tim për një shtet të pavarur e të lirë, për Kosovën republikë. Aktivistët liridashës atdhetarë, në mesin e tyre edhe unë, iu ekspozuan persekutimeve, ishin të kërcënuar me burgime, tortura e vrasje. Për arsye të njohura, mua më është dashur që ta rris shkallën e vigjilencës dhe veprimtarinë ta vazhdoj në fshehtësi të thellë. Kjo formë e të jetuarit është e mbushur me plot rreziqe. Asnjë minutë të vetme nuk kishim siguri. Pa mbështetjen dhe përkrahjen e popullit ne nuk kishim pasur mundësi të mbijetojmë gjatë në Kosovë. Situata u tendos tej mase, kështu që pas tre muaj jete kaçakçe u detyrova të arratisem nga atdheu im.

Kurse në pjesën e dytë e kam përshkruar udhëtimin tim të gjatë, jetën time prej një mërgimtareje të ngarkuar me shqetësimin për vendin tim, për ndodhitë e përditshmërisë dhe ballafaqimin me një situatë tjetër, në përpjekje për t'u kyçur në një shoqëri pa komplekse politike, gjinore e klasore, në përcaktim të detyrimeve për një jetë të pavarur profesionale.

Me arritjen time në Zvicër, në mes të tjerash ndesha edhe vetminë e pamëshirë. U bëra, si të thuash, e fortë për të përballuar shumë vështirësi, por gjithmonë duke pasur dhe ushqyer dashurinë për lirinë e vendit tim. Në këtë pjesë kam shkruar për hapat integrues dhe për perspektiva të reja jete, për sukseset që më falnin lumturinë personale, por edhe për zhgënjimet e vuajtjet të cilat nuk më kursyen si pasojë e dështimeve të shumta në vendin tim, por dhe në diasporë. Ndër të tjera, në libër rrëfej se sa e vështirë ishte ndjenja të jesh e pafuqishme, kur shihja nga distanca se çka përjetonte familja ime dhe përgjithësisht shqiptarët në luftën e Kosovës, në pamundësi që t'u vija në ndihmë. Me një fjalë, kjo pjesë përmban jetën time në Zvicër, në diasporën shqiptare; një jetë mes dy botëve, mes dy kulturave.




*Shtëpia botuese zvicerane "Rotpunktverlag" këtë vit e ka fituar titullin Shtëpia Botuese e Vitit në Zvicër. Cila është përvoja juaj e bashkëpunimit me të?*

**Basrie Sakiri-Murati:** Shtëpia Botuese "Rotpunktverlag" më ofroi mundësinë ta botoj librin tim ngaqë tek ajo zgjoi interesim të madh motivi i tij. Me botimin e librit tim nuk më ka dhënë vetëm mua një shans, por e ka respektuar edhe gjithë popullin tim dhe historinë tonë të lavdishme. Shkrimin e librit, duke pasqyruar një të kaluar plot sakrifica e ngjarje të dhimbshme, e bëra krahas punës profesionale, kështu që shpesh më mungonte koha dhe fuqia e duhur. Mirëpo ishte sjellja tejet humane dhe bashkëpunimi korrekt me ekipin e Shtëpisë Botuese "Rotpunktverlag", posaçërisht me lektorin, zotërinë Adrian Flückiger, që më motivoi dhe dhuroi energji. Ata tek unë vulosën edhe një herë më shumë bindjen time, se sa të saktë, të përpiktë e të ndershëm janë zviceranët në punë dhe profesion. Edhe pse ishte një vit shumë intensiv, ishte një përvojë e mrekullueshme me 'Rotpunktverlag' dhe do t'u jam të gjithëve përherë mirënjohës.

*Cilët janë tre kryeheronjtë e librit? Njëkohësisht na shpjegoni ju lutem për secilin veç e veç, se përse këta të tre e meritojnë këtë epitet?*

**Basrie Sakiri-Murati:** Libri im ka më shumë se tre kryeheronjë dhe po të filloj të shpjegoj për secilin prej atyre, atëherë më duhen faqe të tëra ta përshkruaj gjithë atë heroizëm. Gjatë tre muajve që kam qëndruar e fshehur në Kosovë, në kujtesën time kam më shumë se tridhjetë kryeheronjë e kryeheroina e jo vetëm tre. Ata për lirinë



e Kosovës nuk kursyen as jetën. Na ushqyen e strehuan neve dhe rrezikuan edhe fëmijët në djep. Pa mbështetjen e tyre ne nuk do të kishim pasur mundësi të mbijetonim më tepër se disa ditë në fshehtësi të thellë, se lërë më me muaj të tërë. Përgjigjen më të saktë në këtë pyetje ua lë lexueseve që ta zbulojnë vetë në brendinë e librit.

*Si e shihni nga këndvështrimi i sotëm pjesëtaren e "Çetës së Llapit", "Shqipen"?*

**Basrie Sakiri-Murati:** "Shqipja" ishte një vajzë e një moshe të ndjeshme të rinisë, në një fazë të kërkimit dhe krijimit të identitetit e të personalitetit të saj. Ajo është një vajzë e padjallëzuar, si çdo vajzë e moshës së saj, me dëshirë të pafund ta zbuloj e ta njoh jetën dhe ta mësoj botën e të rriturve. "Shqipja" kishte një kapacitet të mirë t'i vërejë dhe t'i resorbojë gjërat ashtu siç ishin. Relacioni i saj me gjërat dhe rrjedhjen e tyre ka qenë i sinqertë. Çdo gjë e ka marrë me seriozitet dhe e ka resorbuar ashtu siç ishte, pa e interpretuar. Ndjeshmëria e saj ndaj rrjedhave ishte spontane, autentike, prej nga buronin emocione të të gjitha llojeve, që e kompletonin atë si individ. Fakti i kuptimit dhe vetëdijshmëria për kontekstin dhe situatën në vendin e saj, përjetimet e padrejtësisë nga popullata shqiptare, diskriminimi dhe persekutimet masive nga regjimi serb, ishin elemente iniciuese të burimit të një energjie nga thellësia e personit të saj, që të angazhohet në një aktivitet të organizuar, me synim të ndryshimit të rrethanave në vendin e saj. "Shqipja", si e padjallëzuar që ishte, kishte një besim të pafund në ndryshime. Ajo besonte në shokët e grupit të saj, besonte në idealet dhe kapacitetin e realizimit të idealeve të tyre, besonte në familjen e saj, besonte në shoqërinë e gjerë, besonte në popullin e saj, besonte në shumëçka. Ajo mosbesim kishte vetëm ndaj armikut. Ky besim e bënte të ndihet e fortë, i jepte energji. Nga ky besim dhe dashuria ndaj popullit të saj, "Shqipes" i shtohet vullneti dhe vendosmëria të sakrifikohet për t'i ndryshuar rrethanat në vendin e saj.

*Sado që përurimi i librit, që e keni pasur këto ditë në Zürich, ishte organizuar nga botuesi, krahas zvicerанëve, kishte të pranishëm edhe shqiptarë. Kjo flet për interesimin edhe të shqiptarëve për ta lexuar librin tuaj, ani pse në gjuhën gjermane. Ku mund ta gjejnë librin të interesuarit që jetojnë në Zvicër, Gjermani dhe Austri?*

**Basrie Sakiri-Murati:** Prania e bashkatdhetarëve në përurim më ka dhënë shumë kurajë dhe e kam ndjerë veten tejet të lumtur në mesin e tyre. "Bleibende Spuren" pasqyron jo vetëm rrugëtimin tim, por përfaqëson fatin e mijëra shqiptarëve. Prandaj më gëzon fakti se edhe lexuesi shqiptar tregon interesim për ta lexuar librin. Të gjithë të interesuarit librin mund ta gjejnë ose porosisin në të gjitha libraritë, si në Zvicër ashtu edhe në Austri e Gjermani. Gjithashtu, mund ta porosisin edhe online te "Rotpunktverlag" dhe në libraritë e mëdha që kanë faqe interneti.

*Kur është fjala për lexuesin shqiptar, çfarë u ofron libri juaj posaçërisht të rinjve shqiptarë të lindur në vitet '90 në mërgim, kur kemi parasysh faktin që kjo gjeneratë nuk e ka përjetuar me praninë fizike periudhën e paraluftës së Kosovës, e cila është pjesë e këtij libri?*

**Basrie Sakiri-Murati:** Jam shumë e lumtur që kjo gjeneratë nuk e përjetoi fizikisht atë periudhë gjakthithëse, siç e përjetuan bashkëmoshatarët shqiptarë në Kosovë! "Bleibende Spuren" iu ofron atyre ngjarje të dhimbshme, por edhe një histori të lavdishme. Në libër, ndër të tjera, pasqyroj edhe zemërgjerësinë, traditën dhe kulturën shqiptare, gjë që për të rinjtë e kësaj gjenerate do të jetë tërheqëse, edhe pse jam më se e bindur se ata këtë temë e kanë gjithmonë prezentë nga prindërit e tyre. Libri im nuk është vetëm një histori e jetës që dua t'ia dhuroj lexuesit, por është edhe një mesazh për rininë e sotme, se si mund të angazhohet e të kontribuojë, se si mund të dalë nga situata të vështira me të cilat mund të ballafaqohet në jetë.

*A planifikoni që libri "Bleibende Spuren" t'i ofrohet lexuesit edhe në gjuhën shqipe?*

**Basrie Sakiri-Murati:** Dëshira ime, që librin "Bleibende Spuren" ta përkthej në gjuhën e nënës dhe t'ia ofroj lexuesit, ka qenë qysh në ditën e parë që kam filluar ta shkruaj. Kjo do të ishte shumë e rëndësishme, por do t'ia lëmë kohës.

# ME DY SHQIPTARË TË MËDHENJ



**Ismet SYLEJMANI**

Me emrat e mëdhenj e të dëgjuar, anëtarët e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë Prof. Dr. Shaban Sinani dhe Prof. Dr. Irakli Koçollari!

Nga një kafe e pije në kryeqytetin e Kosovës në Prishtinë, në ditët e panairit ndërkombëtar të librit!

Takimi afër simbolit të Pavarësisë së Kosovës NEW BORN, me Prof. Dr. Shaban Sinani e pastaj edhe me Prof. Dr. Irakli Koçollari, ishte natyrisht i rastit dhe u arrit me veprimin tim!

I përshendeta dhe u prezentova! Me shpejtësi i tregova Prof. Shaban Sinanit, arsyen përshendetjes dhe i tregova se në vitin 1991 jemi takuar në Tiranë në përbërjen e delegacionit të LPK- së ku është realizuar edhe takimi me Prsidentin e Shqipërisë Ramiz Alia!

Prof. Shaban Sinani më tha po ti Ismet ishe më i riu nga delegacioni!

E dinte saktë jo vetëm moshën time, ky personalitet i shquar shqiptar, njëri prej këshilltarëve më të lartë të Presidentit të Shqipërisë Ramiz Alia!

Më njoftoi e prezentoi me Prof. Dr. Irakli Koçollarin, të cilin edhe une e kisha të dëgjuar si emer e me funksion të lartë shtetërorë në atë kohë në Shqipëri, tash edhe studiues, historian e autor!

Me ftesën time e në respekt të dyanshëm, u ndalëm të pinim nga një kafe në byfe Monaco në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve, ndonëse ishim duke shkuar në terminet e caktuara me axhendë paraprake!

Biseduam për vizitën në Shqipëri, për anëtarët e delegacionit nga Kosova e Viset e saja, e për Kristaq Porodinin përgjegjësin në Shqipëri!

I tregova Prof. Shabanit për bisedën për Atë, që kisha pasur me Presidentin Ramiz Alia në Prishtinë në vitin 2008 me rastin e 100 vjetorit të ditëlindjes së Udhëheqësit të madh dhe të lavdishëm Enver Hoxha!

Prof. Dr. Shaban Sinani në kuadër të bisedës së ngrohtë, vëllazërore e miqësore që bëmë, mes tjerash më pyeti edhe për njërin prej shokëve e miqve të mijë më të mëdhenj, por edhe për mikun e tij, për botuesin e gazetës ditore EPOKA E RE, gazetarin legjendar të popullit shqiptar, publicistin më të guximshëm, studentin e organizatorin e famshëm të protestave studentore te vitit 1997 në Prishtinë, të nderuarin Muhamet Mavraj e për familjen e Tij!

Ishte knaqësia ime që të dëgjoja tema e biseda njëra pas tjetrës, secila më interesante se tjetra!

U ndava nga këta dy burra të mëdhenj të Atdheut, shumë i knaqur dhe tepër i lumtur që pata rastin t'i takoja!

## Prof. Dr. Shaban Sinanin e takova pas 28 viteve!

Dhe është e jashtëzakonshme sepse u takuam në Prishtinën e lirë dhe në Kosvën e Pavarur, të pranuar e të njohur ndërkombëtarisht shtet sovran!

Lufta heroike dhe titanike e UÇK-së, gjaku i derdhur për liri i Heronjeve dhe Dëshmorëve të Kombit, ndihma dhe kontributi kolosal i Nanë Shqipërisë, i SHBA-ve dhe i NATO-s, bëri të mundur largimin përgjithmonë të Serbisë pushtuese nga Kosova e pamposhtur dhe lavdimadhe!

Populli shqiptar i Kosovës përgjithmonë në jetë të jetëve do të iu jetë mirënjohës Prof. Dr. Shaban Sinanit dhe vëllezërve nga Shqipëria, për kontributin e madh dhëne luftës për liri e pavarësi nga Serbia pushtuese!

**Prishtinë, 8 Qershor 2019!**

E jashtëzakonshme

# Fshati që shfaqet një herë në vit



Një fshat në Indi është i dukshëm vetëm një muaj në vit, pasi në pjesën tjetër të vitit ai zhduken nën ujë. Fshati ndodhet mes dy maleve. "BBC" ka transmetuar se dikur ishte një zonë e begatë dhe pjellore me rreth 3 000 banorë. Në vitin 1985, ky fshat pushoi së ekzistuari për ndërtimin e digës së parë të shtetit, e cila e shkatërroi atë. Çdo vit, megjithatë, në muajin maj, uji ul nivelin e tij dhe në këtë periudhë banorët e vjetër takohen atje.

FOTO E DITES




Një i ri shihet duke kaluar me kali në lumin Eden në Angli. /AFP/

E rrallë

# Qyteti më i errët në botë



Ka vende në botë ku njerëzit mësohen të jetojnë pa rrezet e diellit dhe shpesh iu nënshtrohen terapive me dritë. Në përgjithësi kjo ndikon negativisht në shëndetin fizik dhe atë mendor, pasi një pjesë e madhe e njerëzve preken nga depresioni. Kjo, gjithashtu, ndodh në Rjukan, në qytetin norvegjez të rrethuar me male, i cili nuk ka dritë të drejtpërdrejtë nga muaji shtator deri në mars. Ai njihet si qyteti më i errët në botë.

## BARSOLETA E DITËS



**BURRI: E DASHUR, MË DUHET TË TREGOJ NJË TË VËRTETË TË TMERRSHME. FIRMA KA BANKROTUAR, BABAI MË LA PA HISE, VETURËN E KAM BËRË LLOM. A DO TË MË DUASH ENDE?**
**GRUAJA: NATYRISHT I DASHUR, VETËM SE DO TË MË MUNGOSH SHUMË!**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC




**Vetem gjate vikendit ne ora 14:00**

### "DUMBO" 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

**Rolet:** Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
**Regjia:** Tim Burton



**Ne ora 16:00 dhe 19:00**

### "AVENGERS; Endgame"

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlet Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo

**Në ora 20:00**

### "EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE"

Krim/Mister; 1 ore 48 min




**Rolet:** Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
**Regjia:** Joe Berlinger




**16.05.2019**

### "THE HUSTLE"

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Shumë shpesh humbni në botën e ndjenjave, por kjo gjë ju bën shumë të ndikueshëm dhe mjaft të paqëndrueshëm.



**DEMI**
Si fillim duhet ta krijoni terrenin e përshtatshëm, pastaj të procedoni për t'i realizuar projektet tuaja ambicioze.



**BINJAKËT**
Kurioziteti është arma juaj kryesore sot dhe është dhe një nga virtytet tuaja më të mira. Gjithmonë kërkoni informacion përpara se të veproni.



**GAFORRJA**
Miqtë mund të kenë gjithmonë besim tek ju se dini t'i ruani sekretet dhe jeni mjaft të rezervuar për t'i shprehur ndjenjat tuaja.



**LUANI**
Edhe pse dëshironi të dominoni dhe të jeni gjithmonë në rolin e liderit sot do të dini të ofroheni më shumë qetësi për një mbështetje morale.



**VIRGJËRESHA**
Në ditët që do të vijnë do të keni shumë ngarkesë në punë, por do të dini se si ta përballoni më së miri.



**PESHORJA**
Mundohuni të jeni të kuptueshëm sot dhe mateni fjalët që thoni. Mund të lëndoni pa dashje dikë për të cilin keni shumë respekt.



**AKREPI**
Gjithmonë arrini t'i gjeni zgjidhjet shumë më përpara të tjerëve falë intuitës suaj të pagabueshme që ju ndihmon gjithmonë.



**SHIGJETARI**
Optimist dhe pozitiv gjithmonë e shikoni gotën gjysmëplot, por edhe te njerëzit përçoni të njëjtën ndjesi.



**BRICJAPI**
Nuk ju tremb aspak koha që duhet të impenjoheni për të zgjidhur një çështje të caktuar. Jeni mjaft i përqendruar në detaje.



**UJORI**
Mendoni se të tjerët përkushtohen ndaj jush në të njëjtën mënyrë si ju ndaj tyre. Sot do të pësoni një zhgënjim lidhur me një person.



**PESHQIT**
Keni shumë gjëra pozitive si tip, jeni të ndershëm dhe mjaft korrekt me ata që ju rrethojnë. Sot kjo gjë do të vlerësohet.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Montimi
Servisimi
Porosi
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Reja: Shqipëria ka respekt për secilin, frikë nga askush

"Të gjithë rivalët janë të frikshëm. Nuk ka rivalë të lehtë. Nuk mund të luajmë me idenë që jemi superiorë. Duhet të tregojmë në fushë a jemi superiorë. Në Islandë pashë një Shqipëri me personalitet, që e sulmoi kundërshtarin. Pres të njëjtën paraqitje edhe ndaj Moldavisë, me respekt dhe pa frikë për askënd. Në futboll gjithçka mund të ndodhë por, nëse luajmë mirë, mund t'i kthejmë episodet në favorin tonë", ka thënë Reja



TIRANË, 10 QERSHOR - Kombëtarja e Shqipërisë në futboll sonte (e martë) do ta zhvillojë ndeshjen e radhës kualifikuese kundër Moldavisë në Elbasan. Trajneri i kuqezinjve, Edy Reja, ka thënë se nuk duhet të nënvlerësohet asnjë kundërshtar dhe fusha është për ta treguar superioritetin ndaj rivalëve. "Të gjithë rivalët janë të frikshëm. Nuk ka rivalë të lehtë. Nuk mund të luajmë me idenë që jemi superiorë. Duhet të tregojmë në fushë a jemi superiorë. Në Islandë pashë një Shqipëri me personalitet, që e sulmoi kundërshtarin. Pres të njëjtën paraqitje edhe ndaj Moldavisë, me respekt dhe pa frikë për askënd. Në futboll gjithçka mund të ndodhë por, nëse luajmë mirë, mund t'i kthejmë episodet në favorin tonë", ka thënë Reja, i cili nuk e ka përjashtuar mundësinë që në këtë ndeshje të bëhen katër zëvendësime. "Është ende herët për të vendosur. Do ta shoh formën fizike, dikush mund të pushojë, sepse i kemi rolet të dubluara dhe vetëm ata që janë në 100 % do të luajnë. E kam një ide por, të shohim, duhen edhe 24 orë deri në momentin e ndeshjes. Mund të bëj ndryshime, 3-4 e shumta, në mesfushë dhe në sulm mund të pushojnë disa lojtarë, sepse lojtarët u lodhën shumë duke sulmuar e mbrojtur", ka shtuar ai.

Trajneri Reja e ka komentuar edhe një herë humbjen nga Islanda. Ai ka vlerësuar se kundërshtari të shtunën fitoi më fat, kurse Shqipëria, sipas trajnerit italian, është në rrugën e duhur. "Në realitet Islanda luajti vetëm me topa të gjatë në zonë dhe pati fat me atë gol që shënoi, ndërsa ne nuk konkretizuam, por do të rritemi. Nuk mund të pretendojmë rezultate të mëdha menjëherë, duhet pak durim, por rruga është e duhura. Skuadra është kompakte dhe ka një fizionomi, tani kemi një skuadër të vërtetë. Jo gjithçka mund të jetë e përkryer, por jemi në rrugën e duhur", ka deklaruar Reja. "Kemi ende shumë ndeshje. Nëse i fitojmë të gjitha, është e qartë që mund ta themi fjalën tonë. Në çdo ndeshje do të shkojmë për fitore. Këtë dua nga skuadra. Nëse e bëjmë këtë, do të ishte arritje e madhe, pastaj rezultatet në fushë varen edhe nga episodet. Le të japim më të mirën tonë në çdo ndeshje, llogaritë bëhen më tutje", ka shtuar Reja.

### Hysaj: Shiriti? Një ëndërr që po realizohet

